

I nderuar z. L.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 10.05.2024, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, korrigjuar me ankesën e dërguar më datë 13.05.2024, nëpërmjet së cilës kërkoni të njiheni me aktet dhe metodologjinë e vlerësimit tuaj në kuadër të procedurës së pranimit në shërbimin civil, kodi i shpalljes # 6045, në bazë të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", ju informojmë se:

Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 16, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al

Referuar kërkesës suaj në lidhje me fazën e testimit me shkrim për procedurën e konkurimit me kod 6045, ju bëjmë me dije se në nenin 14, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" përcaktohet:

- “1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e- albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.*
- 2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:
a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;
b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.*
- 3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.*
- 4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.”*

Referuar pikës 4, të nenit 14, të sipërcituar sqarojmë se shpërndarja dhe publikimi i pyetjeve të testimeve me shkrim, në procedurat e konkurimit në shërbim civil, do të cënonte bankën unike të pyetjeve që DAP përdor në hartimin e këtyre testimeve. Në këto kushte, për shkak të natyrës së dokumentacionit të kërkuar dhe praktikës së ndjekur në raste të tjera të ngjashme, me qëllim vënien në dispozicion të këtij informacioni, si rregull caktohet një takim midis kërkuarit dhe anëtarit/anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit, gjatë fazës së shqyrtimit të ankesave për rezultatet në procedurën e konkurimit.

Ndërkohë sjellim në vëmendjen tuaj se kjo mënyrë e ofrimit të aksesit në informacion/dokumentacion publik, e përzgjedhur nga DAP dhe anëtarët e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, garanton të drejtën e individit për informim, në përputhje me ligjin nr.

119/2014, "Për të drejtën e informimit", si dhe jurisprudencën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. 3085, data 25.11.2020, është shprehur: "Gjykata e vlerëson se, informacioni i dhënë nga pala e paditur DAP në bazë të kërkesës së palës paditëse I.O. ka qenë i plotë e në përputhje me parashikimet e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Kështu palës paditëse i është dhënë informacioni i kërkuar (...)."

Për sa i përket vlerësimit të jetëshkrimit (dosjes) dhe vlerësimit të kandidatëve në intervistën e strukturuar me gojë, sqarojmë se vlerësimi bëhet në bazë të udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, të DAP, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur".

Në këtë udhëzim shpjegohet metodologjia e vlerësimit me pikë të kandidatëve nga anëtarët e KPP-së. Udhëzimi nr. 2, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të shërbimit civil janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit (<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>), në mënyrë që të gjithë kandidatët të njihen me procedurën dhe metodologjinë e vlerësimit.

Në procedurën e pranimit në shërbimin civil, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPP-ja nuk administron një formular vlerësimi më vete për secilin kandidat, por liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70 % të pikëve), duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë. Lista me renditjen e kandidatëve sipas pikëve (edhe atyre jo fitues), i dërgohet njësisë përgjegjëse brenda 24 (njëzetëkatër) orëve nga përpilimi i saj. Ky dokument përmban pikët e të gjithë kandidatëve (fitues/jofitues) pjesëmarrës në fazat e vlerësimit (testimit me shkrim/vlerësimin të dosjes/ vlerësimin të intervistës së strukturuar me gojë) dhe administrohet në dosjen e procedurës së konkurrimit.

Për sa i përket rezultateve tuaja në procedurën e pranimit në shërbimin civil kodit 6045- Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Natyrore/Shkenca Inxhinierike", niveli minimal i diplomës "Bachelor", më datë 10.05.2024, ju keni paraqitur ankim me shkrim, brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil. Me procesverbalin e shqyrtimit të ankesës suaj, KPP-ja ju ka sqaruar në mënyrë të detajuar në lidhje me vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistës me gojë, për të cilat ju keni ngritur pretendime. Procesverbali i shqyrtimit të ankesës ju është përcjellë me shkresën e DAP nr. 2426/1 prot., datë 20.05.2024.